



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1103/12 Prot.

Tiranë, më 18.04 2023

**VENDIM**

Nr. 26 dt. 18.04.2023

**“PËR  
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË  
FORMIMIT TË VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE  
NË EDUKIMIN FIZIK, SPORT DHE SHËNDET NË FSHL  
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në mbështetje , të pikës 3 shkronja (b, të nenit 49 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, kreun II pika 3 të Udhëzimit të MAS nr.3, datë 15.02.2023 “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëlshme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/ lëndët e mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe kriteret për hapjen e e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike” nenit 43, pika (d, të Statutit të UST-së, të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, Vendimit të Rektoratit nr.34 datë 05.04.2023 “Për miratimin e dokumentacionit të hapjes së programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në Edukimin Fizik, Sport dhe Shëndet në FSHL”, në Vendim nr. 45 datë 07.04.2023 të Senatit Akademik “Për miratimin e hapjes së programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën “Psiko-Pedagogjike në Edukimin Fizik, Sport dhe Shëndet” në FSHL” Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 18.04.2023,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në “Edukimin Fizik, Sport dhe Shëndet”, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, të UST-së. sipas dokumentacionit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqe [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) dhe tek trasparenca universitare.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

